

ALBPETROL SHA PATOS**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 15.01.2020

Nga: "Albpetrol "sha - Patos

Për: "Vesa 2014" shpk,

Adresa: Lagjja 16 Prilli, Rruga Llukan Toska, afër stadiumit, Fier

NUIS L42612401O

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim" me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-46271-12-16-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje Tel avolzhimi dhe materiale ndihmëse".

Kohezgjatja e kontrates është 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Fondi limit: 7,931,625 lekë (pa TVSH).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: 23 Dhjetor 2019 nr.51

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Operatori ekonomik "Muhoplus Ltd" shpk me NUIS L52317046G, me vlerë oferte në total 7 500 000 lekë (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "Vesa 2014" sh.p.k. me NUIS L42612401O me vlerë oferte në total 7 771 000 lekë (pa TVSH).

Nuk ka patur ankesa.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "Muhoplus Ltd" shpk :
 - Në shtojcën 2/1 "deklaratë për paraqitje oferte të pavarur", deklaruesi Muhoplus Ltd si ofertues në këtë tender, ka plotësuar pikën 6 germa "b", si më poshtë:
Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të

operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). Kjo deklaratë është në kundërshtim me ofertën e paraqitur në tender nga ofertuesi “Muhoplus ltd”, pasi operatori ekonomik ka dhënë ofertë i vetëm dhe jo si bashkim operatorësh ekonomikë.

- Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kompania “Hes Hacilar Elektrik Sanayi Ticaret A.S”, si prodhues zyrtar i kablllove të energjisë, kablllove të telekomunikacionit, për tel bakri të emaluar dhe përçuesve të bakrit. Njëkohësisht ka paraqitur katalogun e materialeve ndihmëse për “karton prespa, tubo stilingato, dhe llakun izolues” të prodhuesit “Hes Hacilar Elektrik Sanayi Ticaret A.S”, ndërkohë që prodhuesi autorizon ofertuesin vetëm për produktet e prodhuara nga ai si tel bakri i emaluar dhe përçuesve të bakrit. Pra nuk bëhet lidhja midis autorizimit të prodhuesit dhe katalogut të paraqitur.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Vesa 2014” shpk, me adresë Lagjja 16 Prilli, Rruga Llukan Toska, afër stadiumit, Fier, me NUIS L426124010, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7 771 000 (*shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë*) lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier – Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit për Prokurimet Publike nr. 9643 datë 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.01.2020.

Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erjola MUKA

